



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060-43805 dt. 29 09 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **21.09.2022**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati, Malsore Cakiqi, Azemine Bujupi Gjoka, Hamit Haxhiu, Arbër Halilaj, Florentina Elezi-Veliu si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 24.08.2022.
2. Raporti i degjimeve publike për listen e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.
3. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
4. Propozim vendim për formimin e Komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionereve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A – Gillogoc.
6. Propozim vendim- Me këtë propozim vendim kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF “Dr. Hafir Shala” Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale- Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.
7. Plani i Implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 24.08.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës. **2. Raporti i dëgjimeve publike për listen e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, i falenderoj kryesuesin si dhe asambleistët të cilët kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore, dhe kjo që e keni bërë ju i ndihmon komunës për performancë komunale, dhe i hyn në shërbim edhe komunës por edhe në të mirë të qytetareve.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.**

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, buxheti i përgjithshëm i Komunës për vitin 2023 është 18.156.892.00 euro, ndërsa nga kjo shumë për investime kapitale janë planifikuar 6.335.649.00 euro apo 34.89%.

Florentina Elezi-Veliu, unë i kam shiku edhe në ueb faqe të komunës edhe dëgjimet publike që janë bërë, sa kam shiku nuk është marrë asnjë kërkesë nga qytetaret dhe që është fut në buxhet po ashtu nga hera e kaluar që e patëm mbledhjen nuk është bërë asnjë ndryshim është i njëjti propozim i buxhetit, kështu që vota ime është kundër.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, si kuvend komunal edhe gjitha komunat e Kosovës kanë më ju përmbajta këtyre kriterëve, ne i kemi mbajtur dëgjimet buxhetore kerksat e qytetareve nuk kanë asnjë për vitin 2023 por gjitha kërkesat e tyre kanë qenë për projektet e vitit 2022.

Pasi që nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota (Për), 1 kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për formimin e Komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.**Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionereve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A – Glllogoc.**

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente Lumnije Krapi, ky dokument është në proces pas miratimit të këtij dokumenti, ky komision duhet të ushtroj detyrën në bazë të ligjit në përputhje me ndërmarrjen publike, komisioni duhet të formohet nga dy anëtar nga Kuvendi i Komunës dhe 1 nga ekzekutivi.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim- Me këtë propozim vendim kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF “Dr. Hafir Shala” Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale- Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.**

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, automjetet që kanë qenë të regjistruara në emër të “Dr. Hafir Shala” Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale- Drenas, që t’i kthejmë në tabela zyrtare nje herë duhet të kalojnë në pronë komunale pastaj të vazhdojmë procedurat e regjistrimit të tyre.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, këto automjete janë prona komunale por me udhëzim administrativ është kërkuar që tabelat me i pas zyrtare janë në emër të QKMF-së dhe duhet të kaloj në emër të komunës.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Plani i Implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe e rekomanduan për mbledhje të rregullt si pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të ndryshme.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kërkoj që për mbledhjen e rregullt të sjellin Raport menaxheret e dy Kompanive KRU- „Ujësjellësi”, dhe KRM- „Pastrimi” njësia Drenas. Pasi nuk pati diskutime te tjera mbledhja përfundoi në ora **10:45 min**.

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari